



| |
|--|
| REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVO QEVERTIA E KOSOVËS / VLADA KOSOVA GOVERNMENT OF KOSOVO MINISTRIA E DREJTËSISË / MINISTARSTVO PRAVDE MINISTRY OF JUSTICE |
| Nr.Br.No: 08-975/3 |
| Data / Datum / Date: 11 / 12 / 2024 |
| Shtojca / Dodaci / Annex: -3- |
| PRISHTINË/A |

Republika e Kosovës
Republika Kosova-RepublicofKosovo
Qeveria –Vlada-Government

Ministria e Drejtësisë – MinistarstvoPravde – MinistryofJustice

Departamenti për Profesione të Lira-DepartmantSlobodnihProfesija-
DepartmentofFreelanceProfessions

Komisioni Disiplinor/Disiplinska Komisija/The Disciplinary Comitee

DPL.nr.11/2024

KOMISIONI DISIPLINOR PËR PËRMBARUESIT PRIVAT, në përbërje nga Manush Karaci kryesuese, Adnan Konushevci dhe Rushit Hoxha, anëtarë të komisionit disiplinor për përmbaruesit privat, në çështjen disiplinore ndaj përmbaruesit privat, , si organ përmbarues, i emëruar nga Ministria e Drejtësisë e Republikës së Kosovës për Territorin e Gjykatës Themelore në , lidhur me veprimet përmbarimore në lëndët përmbarimore, P.nr.283/23, pas mbajtjes së seancës dëgjimore publike, në të cilën ka prezantuar përfaqësuesja e Ministrisë së Drejtësisë - Departamenti për Profesione të Lira - Divizioni për Noterinë dhe Përmbarimin Privat, Burbuje Spahija -Kërveshi dhe Përmbaruesi Privat e në mungesë të palës ankuese , me seli në , të cilën ka përfaqësuar , me datë 07.11.2024, mori këtë:

V E N D I M

REFUZOHEN Raporti përfundimtar i Ministrisë së Drejtësisë-Departamenti për Profesione të Lira- Divizioni për Noterinë dhe Përmbarimin Privat, DPL-11/2024 i datës 04.06.2024, si dhe ankesa e palës ankuese , me seli në , e datës 22.05.2024, si të pabazuara.

Përmbaruesi Privat , si organ përmbarues, i emëruar nga Ministria e Drejtësisë e Republikës së Kosovës për Territorin e Gjykatës Themelore në , nuk është përgjegjës për shkelje të pretenduara disiplinore gjatë veprimeve të ndërmarra në lëndën përmbarimore, P.nr.283/24 .

A r s y e t i m

Pala ankuese, . me seli në . përmes të autorizuarit të tij ka parashtruar ankesë ndaj përmbaruesit privat duke pretenduar se përmbaruesi privat ka bërë shkelje për lëndën P.nr.283/24 , sepse fillimisht ka ndryshuar numrin e lëndës , pastaj përmbaruesi ka ndërmarrë veprimin e tretë në këtë lëndë e kështu ka bërë shkelje duke mos pezulluar procedurën sipas dispozitive të nenit 65, par.1, nën par.1.2 dhe 3 të LPP-së.

Gjithashtu sipas palës ankuese përmbaruesi vepriemt e ndërmarra i kë bërë në selinë e një kompanie tjeter që nuk ka qenë fare palë në procedurë , duke nxjerrë pa bazë ligjore konkluzion për inventarizim të sendeve me vendosjen e shiritave dhe duke larguar punëtorët nga selia e biznesit tjeter me pretendimin se është selia e debitorit dhe ato sende janë të debitorit. Me këto vepprime është dëmtuar edhe kompania .
në duke i pamudnësuar kryerjen e punëve për shtrimin e rrejtit të ujësjelësit dhe kanalizimit.

Me këtë sipas palës ankuese përmbaruesi ,ka bërë shkelje të dispozitave të nenit 65 të LPP-së duke mos pezulluar procedurën përkundër disa vepprimeve të ndërmorra nga përmbaruesi paraprak lidhur me këtë lëndë dhe pastaj edhe veprimet e vet këtij përmbaruesi.

I ka propozuar komisionit që të aprovohet ankesa dhe duke u bazuar në dispozitat e nenit 365, 366, 367 par.1 pika 1 dhe 2 dhe 368 p.1, lidhur me nenin 368 par.1 të LPP-së, ndaj përmbaruesit të ndërmirren masa adekuate .

Përmbaruesi Privat, në përgjigjen e tij dhe në seancën e datës 07.11.2024, ka dekluaruar se fillimi shisht sa i përket ndërrimit të numrit të lëndës, ky numër ka ndryshuar për shkak se rasti është transferuar nga përmbaruesja tjeter dhe në momentin kur është transferuar rasti, si lëndë e re në zyre ka marrë numrin e ri të zyrës së përmbaruesit aktual, por nuk ka ndryshuar asnjë gjë tjeter, përpos si evidentcë nga përmbaruesja paraprake tek ky përmbarues.

Nga shkresat e lëndës ka vërejtur vetëm bllokim të llogarive nga përmbaruesja
nga e cila edhe është bërë trasferimi i kësaj lënde.

Lidhur me pretendimet se përmbaruesi duhet të pezulloj procedurën pas dy vepprimeve të pa suksesëshme, ka dekluaruar se nuk konsiderohet veprim i përsëritur i pa suksesëshëm , pasi me veprimin e daljes në terren është hasur në sende të debitorit.

Lidhur me pretendimin tjeter se përmbaruesi ka vendosur shirita tek selia që nuk ka qenë seli e debitorit, përmbaruesi deklaroi se ai qe disa vite që punon, asnjëherë nuk ka vendosur askund shirita si dhe lidhur me atë se selia nuk ka qenë e debitorit dhe është bërë inventarizimi i sendeve të huaja e jo të debitorit, sipas përmbaruesit, selia ka qenë e njejtë bazuar në adresat që ka pasur dhe si dëshmi ka ofruar foto nga vendi i ngjarjes ; ndërsa për pronësinë e sendeve përmbaruesi ka theksuar se ka prova zyrtare nga ana e ATK-së e gjithashtu palës pretenduese lidhur me pronësinë e sendeve të inventarizuara, palëve u është dhënë afat për vertetim të pronësisë lidhur me ato sende, e që palët nuk e kanë bërë vërtetimin e pronësisë.

I ka propozuar komisionit që ankesa të refuzohet , pasi nuk ka shkelje disiplinore nga ana e tij..

Në seancën dëgjimore, i autorizuari i palës ankuese ka munguar përkundër që ka pasur ftesën për senacë dhe përmes postës elektronike ka njoftuar komisionin që nëse komisioni vendos për mbajtjen e seancës të bazohet në provat e bashkangjitura në ankesë.

Komisioni ka pasur parasysh njoftimin për mungesë të paës ankuese në seancë, por nuk ka pasur pengesa për vazhdim të seancës dhe pasi nuk ka pranuar prova tjera është bazuar në provat e pranuara me rastin e parashtrimit të ankesës nga pala ankuese, seanca është mbajtur në prani të përmbaruesit privat dhe në mungesë të palës ankuese.

Komisioni nuk ka gjetur ndonjë provë me të cilën do të provohej që përmbaruesi privat ka bërë tejkalim të autorizimeve dhe shkelje ligjore sipas pretendimeve në ankesë dhe nuk ka mundur të vërtetohet se me provat e ofruara, i njejti ka bërë ndonjë shkelje ligjore, pasi numri i rastit është ndryshuar pasi kemi pasur trasferim të rastit nga zyra e përmbaruesit paraprak dhe numri është vetëm si regjistar për zyren e përmbaruesit,, ndërsa veprimet tjera kanë mbetur në fuqi nga përmbaruesi paraprak.

Nuk qëndron pretendimi për mos pezullim të rastit dhe inventarizim të sendeve të personit të tretë, sipas shkresave të lëndës, pasi përmbaruesi u ka dhënë afat palëve të dëshmojnë pronësinë mbi ato sende e që nuk është bërë nga pala e tretë dhe bazuar në raportet e ATK-së dhe provat e daljes në terren për mos ekzekutim të urdhërit dhe dorëzimit të paluajtshmërisë sipas kërkesës së kreditorit dhe vendimeve të vet përmbaruesit, pasi në dispozitat ligjore që regullojnë këtë pjesë nuk ka ndonjë afat që e kushtëzon kryerjen e këtyre veprimeve dhe përfundimin e kësaj procedure brenda këtij afati, por varësisht prej rrjedhave të procedurës kryhen edhe veprimet përmbarimore tek këto raste.

Mbi bazën e të dhënave si më lart, Komisioni vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

KOMISIONI DISIPLINOR PËR PËRMBARUESIT PRIVAT

DPL.nr.11/2024 datë 07.11.2024

Kryesuesja e Komisionit Disiplinor

Manushe Karaçi



KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij vendimi pala e pakënaqurka të drejtë të hap konflikt administrative bazuar në nenin 374 par 5 të LPP-së.